

## **KUSHTET E GARANCIONIT PËR APARATE SALDUESE**

Të gjitha aparatet salduese të Wurth, testohen dhe i nënshtrohen kontrolleve më të rrepta të Wurth sistemeve për siguri të cilësisë së produkteve.

Për të gjitha Wurth aparatet salduese japim garancion me kushtet si vijon:

### **GARANCIONI:**

1. Garancioni vlenë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e blerjes së aparatit saldues i cili listohet në fletëgarancionin e bashkëngjitur me faturën origjinale të blerjes së aparatit.
2. Garancioni vlenë vetëm atëherë kur aparati saldues i dorëzohet përfaqësuesit të shitjes (agjentit) të Wurth, vendit ku është blerë aparati apo serviserit të autorizuar për evitimin e defekteve apo mungesave.
3. Garancioni përfshinë të gjitha defektet në pajisje që janë pasojë e të metave në materialet nga të cilat është prodhuar aparati, ose defekteve si pasojë e gabimeve në procesin e prodhimit.

Përderisa janë përbushur kushtet e lartpërmendura, për periudhën nën garancion, Wurth-Kosova shpk mbulon të gjitha shpenzimet e riparimit të aparatit.

Nëse aparati i është dorëzuar përfaqësuesit të Wurth-Kosova Shpk, kjo e fundit merr përsipër shpenzimet e transportit.

Wurth-Kosova shpk obligohet që aparati të riparohet brenda afatit të përcaktuar ose ta zëvendësojë me të ri.

### **GARANCIONI NUK VLENË NË KËTO RASTE:**

1. Nëse blerësi së bashku me aparatin nuk sjellë fletëgarancionin dhe faturën origjinale të blerjes.
2. Nëse blerësi ose përdoruesi nuk i është përmbajtur udhëzimeve për përdorim të drejtë dhe mirëmbajtje të aparatit.
3. Nëse brenda afatit të garancionit, aparati është hapur nga servisi i paautorizuar, apo nga ndonjë palë e tretë, garancioni automatikisht nuk vlenë, ndërsa të gjitha shpenzimet e riparimit dhe transportit i bartë vetë blerësi.
4. Nëse brenda afatit të garancionit është paraqitur defekti si rezultat i konsumimit të pjesëve të aparatit, përdorimit jo të drejtë të aparatit, modifikimit të aparatit, apo përdorimit të pjesëve jo-origjinale. Në këto raste të gjitha shpenzimet e riparimit i bartë vetë blerësi.

Wurth-Kosova shpk është e obliguar të sigurojë pjesë rezervë dhe funksionim të servisit në periudhë prej 5 (pesë) vite nga data e blerjes së aparatit e shenuar në fletëgarancion.

Për pjesët dhe kualitetin e shërbimeve të servisit për aparatet të cilat riparohen në servisin e Wurth-Kosova por që nuk janë nën garancion, ne japim garancion në afat prej 6 (gjashtë) muaj.

Kryerja e shërbimeve të cilat rezultojnë si pasojë e këtij garancioni nuk zgjasin afatin e garancionit të cekur në fletëgarancion.

Përveç të drejtës së evitimit të defekteve në aparat të cilat janë definuar me këtë fletëgarancion, nga i njëjti nuk rrjedhë asnjë e drejtë tjetër.

**FALEMDERIT PËR MIRËKËPTIMIN DHE BESIMIN TUAJ!**